



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 68, Datë 02.03.2026

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË  
“DION ENERJJI” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT  
TË ENERJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 02.03.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 667/1 prot., datë 26.02.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “DION Energji” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

**Konstatohet se:**

- Shoqëria “DION Energji” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 667 prot., datë 17.02.2026, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në zonën e kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se:

**Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren**

- Në përputhje me nenin 9, pika 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas gërmave (a, b dhe c), duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në Shtojcën 1.
- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas gërmave (a, b, c dhe d).
- Në përputhje me nenin 9, pika 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar gërmave (a dhe b).
- Në përputhje me nenin 9, pika 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas gërmave (a, b, c, d dhe e).

## **Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera**

- Shoqëria ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë kontratën, datë 06.04.2023 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 MW dhe veprave ndihmëse, në zonën kadastrale 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria “DION ENERGJI” sh.p.k.”;
- Shoqëria ka depozituar në ERE “Marrëveshjen e Lidhjes së Re” nr. 6359/2 prot., datë 28.06.2022, të nënshkruar ndërmjet palëve Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.) dhe shoqërisë “DION Energji” sh.p.k.;
- Shoqëria është pajisur me VNM Paraprake, lëshuar më 13.11.2024 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për zhvillimin e projektit “Centrali diellor fotovoltaike”, me kapacitet 2 MW.
- Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

### **NENI 9**

#### **Formati dhe dokumentacioni për aplikim**

#### **Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë**

##### *Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal*

- **gërma “c”**: Shoqëria duhet të përditësojë planin e biznesit, duke paraqitur parashikimet përkatëse për një periudhë 30-vjecare, aq sa është vlefshmëria e licencës.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “DION Energji” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “DION Energji” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**